



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7 regjistër (JR)
Datë 14.02.2023

Nr. 59 i vendimit
Datë 22.07.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.07.2025, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 7/2023 (JR), datë 14.02.2023, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 605, datë 21.12.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka).

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme të përfaqësuar nga prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. Adnan Xholi, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 605, datë 21.12.2022, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, si rrjedhojë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar⁵, duke konstatuar se:
 - (i) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.
 - (ii) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 - (iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
 - (iv) Nuk ka kryer deklarim të rremë.
 - (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***}, datë 25.01.2017.

³ Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 25.01.2017.

⁴ Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme më datë 25.01.2017, referuar datës në formularin e vetëvlerësimit profesional.

⁵ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 23.07.2018.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport⁶ pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmëri të subjektit të rivlerësimit në vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara prej saj gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm⁷, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka) nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për këtë subjekt, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 605, datë 21.12.2022.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Me vendimin nr. 605, datë 21.12.2022, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

7.1 Lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çmon se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.

7.2 Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.

7.3 Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues, në mungesë të evidentimit të ndonjë mangësie apo defekti, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 14.10.2022.

⁷ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2022.

III. Shkaqet e ankimit

8. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 03.02.2023, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 605, datë 21.12.2022. Komisioneri Publik pretendoi se, nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmohet se vendimi është i cënueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, para Kolegjit. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu se përfundimet e arritura nga Komisioni duket se nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.
9. Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit, duke pretenduar se, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe gjendjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Armida Moçka, dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
10. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik, bazuar në nenet Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenet 4 , 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë *ndryshimin e vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Mocka)*.
11. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi pjesën takuese dhe provueshmërinë e burimit të krijimit: (i) të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament me sipërfaqe 106 m²”, në Vlorë; (ii) të pasurisë së paluajtshme të llojit “garazh” me sipërfaqe 23,04 m² në Vlorë; dhe (iii) të të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti privat i familjes bujqësore, ullishte, vreshtari, bujqësi në vlerën 53.000 euro – të deklaruara këto në deklaratën e pasurisë *vetting*, me burim krijimi të ardhurat nga aktiviteti i familjes bujqësore prej 5 anëtarësh, nga viti 1994 – 2011.

11.2 Aplikimi nga Komisioni i parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, në gjendjen që janë aktet, duket se nuk qëndron, pasi pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nuk është në masën/vlerën që mund të gjejnë zbatim këto parime, të aplikuar deri më tani në jurisprudencën e Kolegjit gjatë ushtrimit të kontrollit të pasurisë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁸ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit, i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve, në datat: 30.06.2025, 04.07.2025, 11.07.2025, 17.07.2025 dhe 22.07.2025.
15. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës⁹ dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 30.06.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
16. Në seancën e datës 04.07.2025, në parashtrimet e tij lidhur me ankimin, përpara Kolegjit, të paraqitura edhe me shkrim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Altin Dumani, deklaroi se u

⁸ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 605, datë 21.12.2022, për rivlerësimin e subjektit, znj. Armida Hamiti (Moçka), i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 20.01.2023, me shkresën nr. {***} prot. të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërimarrjes përkatëse, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 03.02.2023, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 03.02.2023, që rezulton të jetë dita e 14-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁹ Referuar parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, me mbarimin e mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit të ushtruar në datën 3.2.2023 nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit, dhe çmoi se në gjendjen që janë aktet, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, si dhe se konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk gjeti referencë në dispozitat kushtetuese e ligjore, apo në një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit. Sipas tij, në këto rrethana, vlerësohet se, *referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, të administruara për efekt të procesit të rivlerësimit dhe gjendjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të, ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016*. Për rrjedhojë të sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i qëndroi kërkimit të ankimit për ndryshimin e vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka).

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Armida Hamiti Moçka, në parashtrimet e saj lidhur me ankimin e ushtruar nga Komisioneri Publik, u shpreh se në vlerësimin e saj shkaqet e ngritura në ankim janë të atilla që: (i) nuk mbështeten në një vlerësim të drejtë dhe objektiv të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit dhe ligjshmërisë së vlerësimit të provave; (ii) shkaqet e ankimit përmbajnë kontradikta të natyrës faktike dhe juridike, të cilat nuk qëndrojnë përballë analizës së plotë të provave të kryera nga Komisioni; dhe (iii) janë në kundërshtim me standardin e provueshmërisë së kërkuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe me praktikën e qëndrueshme të Kolegjit. Subjekti i rivlerësimit kërkoi mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt ankimi si vendim *të bazuar plotësisht në prova dhe në ligj*. Në kuadër të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit paraqiti së bashku me parashtrimet e tij edhe disa akte shkresore, për të cilat kërkoi administrimin e tyre nga Kolegji në cilësinë e provave të reja në proces dhe çeljen e hetimit gjyqësor me qëllim shqyrtimin e plotë të rrethanave të reja faktike që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe burimit e të ardhurave të deklaruara.
18. Në vijim, në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provave të reja në proces, të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e saj gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj dhe, për rrjedhojë, çeljen e hetimit gjyqësor, trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm¹⁰, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me përjashtim të atyre që nuk përmbushnin kriteret e kërkuara nga ligji për sa i përket formës¹¹. Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit dha përgjigje lidhur me disa pyetje të drejtuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

¹⁰ Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 04.07.2025.

¹¹ Aktet me numërtim 3 (tre) dhe 4 (katër) në inventarin e akteve, si dhe formulari urdhër transferte, depozituar nga subjekti i rivlerësimit nuk u pranuan nga trupi gjykues në cilësinë e provës pasi rezultuan të jenë fotokopje apo/dhe printime nga sisteme të ndryshme elektronike, për të cilat nuk u provua gjatë gjykimit në Kolegj origjinaliteti i këtyre shkresave në përputhje me kërkesat e legjislacionit procedural civil në fuqi.

19. Pas përfundimit të hetimit gjyqësor, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i përfaqësuar në gjykim sipas autorizimit nr. {***} prot., datë 10.07.2025, nga prokurori Adnan Xholi, deklaroi se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, për shkak të specifikave të këtij rasti, që lidhen me momentin e krijimit/materializimit të pasurive në emër të subjektit, kohë në të cilën rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e prokurorit apo në ndonjë funksion tjetër publik në kohën e krijimit të tyre, vlerësohet se nuk ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit me detyrën e tij, në krijimin e pasurive të deklaruar. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, edhe pse në përfundim të hetimit administrativ mbeti i paprovuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se në cilësinë e pjesëtares së familjes bujqësore, ajo zotëron vetëm 20% të titullit të pronësisë për pasuritë e paluajtshme: (i) apartament banimi me sipërfaqe 116 m²; dhe (ii) “garazh me sipërfaqe 23,04 m²”, me adresë në lagjen “{***}” Vlorë, rrethanat e rezultuara në përfundim të këtij gjykimi, lexuar në harmoni dhe me parashtrimet dhe provat e depozituara rishitazi nga subjekti i rivlerësimit, vlerësohen bindëse.
20. Për Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, nisur nga fakti se gjatë hetimit në Komision dhe shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk ka rezultuar ndonjë indicie apo e dhënë nga burime të tjera, lidhur me dy kriteret e tjera të rivlerësimit, përfundimisht vlerësohet se problematikat e konstatuara nuk janë të tilla që të justifikojnë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka). Në vijim të sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, bazuar në parashikimet e nenit F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka).
21. Lidhur me qëndrimin e mësipërm, i pyetur nga Vëzhguesja Ndërkombëtare Elka Ermenkova mbi interesin e ligjshëm për të mbajtur ankimin ndërkohë që kërkohet që vendimi i Komisionit të lihet në fuqi dhe, nëse konsiderohet ky qëndrim si tërheqje e ankimit, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme u përgjigj se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e konsideron të rëndësishëm kontrollin gjyqësor të vendimit të Komisionit nga Kolegji dhe, për këtë arsye, nuk ka hequr dorë nga ankimi, por kërkoi që, në përfundim të gjykimit, vendimi i Komisionit të lihet në fuqi si një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova.
22. Bazuar në këto fakte juridike të natyrës procedurale, pasi vërejti se ankuesi, gjatë gjykimit të çështjes, ndryshoi kërkimin e parashtruar fillimisht në ankim, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji që vendimi i kundërshtuar nëpërmjet ankimit, të lihet në fuqi, trupi gjykues vlerësoi si thelbësore për zgjidhjen e çështjes përcaktimin e pasojës juridike procedurale të këtij kërkimi.
23. Në kuadër të kësaj analize, në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik, ka disponuar deri në përfundim të mandatit të tij kushtetues, në mënyrë të plotë dhe të pavarur të drejtën e ushtrimit të ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës, si pasojë e mbarimit të mandatit kushtetues të këtij institucioni dhe kalimit të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore

te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, rrjedhimisht ky i fundit tashmë gëzon në mënyrë ekskluzive edhe të drejtën e disponimit mbi ankimet e ushtruara prej Komisionerit Publik.

24. Trupi gjykues vëren se ankimi është një mjet procedural nëpërmjet të cilit ankuesi, në mbrojtje të interesit publik, kundërshton mbi bazë faktike dhe ligjore drejtësinë e vendimit të Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në rast se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i ankimit, deklaron para Kolegjit se nuk e kundërshton më vendimin e Komisionit, kjo nënkupton se për të nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimuar, duke e lënë në këtë rast ankimin pa objekt, si dhe duke konfirmuar njëkohësisht se ndryshimi i vendimit të Komisionit nuk përbën tashmë një kërkim që i shërben interesit publik. Në këtë kontekst, lënia e ankimit pa objekt dhe humbja e interesit të ligjshëm në ushtrimin e këtij mjeti procedural, pavarësisht deklarimit të ankuesit në seancën gjyqësore publike për mosheqje dorë nga ankimi, në vlerësimin e trupit gjykues, përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt ankimi, për sa kohë ankimi humbi objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit.
25. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pasoja e vetme ligjore për situatën faktike procedurale, si më sipër konstatuar e analizuar, është pushimi i shqyrtimit në Kolegji të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit me nr. 7/2023 (JR), që lidhet me subjektin e rivlerësimit, znj. Armida Hamiti (Moçka), pasi vijimi i gjykimit për kontrollin e vendimit të Komisionit mbi bazën e një ankimi, të mbetur pa objekt dhe në mungesë të interesit të ligjshëm të ankuesit, do të përbënte cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor.
26. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen të nevojshëm të deklarojë edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, i cili ishte objekti i ankimit të Komisionerit Publik. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji konstaton se, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenet 1, pika 2 dhe 44 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenit 451, germa “b” e Kodit të Procedurës Civile, vendimi i Komisionit nr. 605, datë 21.12.2022, ndaj të cilit ishte ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 605, datë 21.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 22.07.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi